



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË  
BORDI

VENDIM

Nr. 201, Datë 01.10.2021

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 187, DATË 10.11.2017,  
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAS SH.A. NË AKTIVITETIN E  
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 123/4 prot., datë 29.09.2021, “Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017 “Për licencimin e shoqërisë ALBGAS sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror” i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 153, datë, 30.06.2021, ndër të tjera vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:
  - Të licencojë shoqërinë “ALBGAS” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që:
    - a. brenda datës 20.01.2022, të depozitojë në ERE Lejet dhe Autorizimet Mjedisore.
    - b. brenda datës 30.09.2021, të depozitojë në ERE Certifikatën e Sigurimit.
  - Dokumentacioni i cili duhet të plotësohet nga shoqëria “ALBGAS” sh.a. deri në datën **20.09.2021**, sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 187/2017 të ndryshuar, është si më poshtë:
    - Depozitimi në ERE i një Certificate Sigurimi (neni 9, pika 1, gërma “e”, iv), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”
  - Shoqëria “ALBGAS” sh.a., ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar që lidhet me Certifikatën e Sigurimit deri në datën 20.01.2022, duke argumentuar se aktualisht ka nisur procedurën e prokurimit për përzgjedhjen e subjektit i cili do të pajisë këtë të fundit më Certifikatë Sigurimi.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: *“Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”*
- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 153, datë 30.06.2021.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar si më poshtë:
  - *“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që **brenda datës 20.01.2022**, të depozitojë në ERE Lejet dhe Autorizimet Mjedisore dhe Certifikatën e Sigurimit.”*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit AHMETI**